

# KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Informim Dhe Privatësi

Revista nr.4



**PRIVATËSI**

**TRANSPARENCË**

**INFORMIM**

**PROGRAM**



Nr. 4  
Dhjetor 2017

## Përmbajtja

Urimi.....	faqja 3
Institucionet e vetting-ut dhe ligji “Për të drejtën e informimit”.....	faqja 3
“Informim dhe Privatësi”, Shkolla Verore në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”.....	faqja 4
Trajnimi “Videosurvejimi dhe mbrojtja e të dhënave personale”.....	faqja 6
Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave, ndikimi në vendet candidate për anëtarësim në BE.....	faqja 7
“Mbrojtja e privatësisë në media”.....	faqja 8
Manuali i të Drejtës Evropiane në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave.....	faqja 9
28 Shtatori, Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim.....	faqja 10
Prezantimi në Konferencën “Mbrojtja e të Dhënave dhe e Drejta e Informimit - në kontraditë apo në mbështetje të njëra-tjetrës”.....	faqja 10
Forcimi i rolit të koordinatorit të të drejtës për informim, takimet e “Grupit të Fokusuar”.....	faqja 11
Vlerësimi i zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”, takim me organizatat e shoqërisë civile .....	faqja 11
Komisioneri anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë.....	faqja 12
Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve për të Drejtën e Informimit...	faqja 13
Konferenca e 10-të dhe Asambleja e 11-të e Përgjithshme e Shoqatës Frankofone të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave.....	faqja 13
Fushata “Privatësi dhe Siguri”, konsultimi i “Kuatrit të aftësimin të mësuesve të shkollave 9-vjeçare për mbrojtjen e të dhënave personale”.....	faqja 14
“Informim dhe Privatësi” - Trajnim në Akademinë e Policisë.....	faqja 16
Konferenca rajonale “Për të Drejtën e Informimit” - Sarandë.....	faqja 17
Zyra e Komisionerit në forume kombëtare.....	faqja 18

Print:

## Revista “Informim Dhe Privatësi”

Apa Albpartners sh.a.

Dhjetor 2017

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, Kodi postar 1001, Tiranë.

Redaksia: Irma Arapi, Alketa Koja, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ju uron  
Gëzuar Vitin e Ri 2018!

## Institucionet e vetting-ut dhe ligji “Për të drejtën e informimit”, intervistë e Komisionerit për BIRN-Albania

Opinionin publik ka pritshmëri të lartë për Reformën në Drejtësi dhe në veçanti, për zbatimin e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Në një shkrim-analizë në portalin reporter.al, që publikohet nga BIRN-Albania (Balkan Investigative Reporting Network), z. Besnik Dervishi, i pyetur se cili është roli i Zyrës së Komisionerit në procesin e vetting-ut, deklaroi se organet e ngritura për këtë qëllim si Autoritete Publike duhet të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

*“Institucionet e vetting-ut kanë detyrimin që të hartojnë programin e transparencës, pra të japin informacionin pa kërkesë, t’u përgjigjen çdo kërkesë të qytetarit për informacionin që kërkon, natyrisht duhet të ngrënë si të gjithë autoritetet e tjera publike regjistrin e kërkesave dhe të përgjigjeve” tha z. Dervishi. Ndërsa, i pyetur për pozicionin e partnerëve ndërkombëtarë në këtë proces, ai deklaroi se “paçka statusit të veçantë që gëzon veprimtaria e ONM (Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit), ajo duhet t’i nënshtrohet transparencës, njësoj si tre organet e tjera të vetting-ut, për shkak të interesit të lartë publik”.*

Transparenca është një nga shtyllat kryesore të Reformës në Drejtësi. Zyra e Komisionerit vlerëson se përmbushja e detyrimeve ligjore nga të gjitha institucionet në zbatimin e saj do të garantojë një proces gjithëpërfshirës dhe të hapur.

## “Informim dhe Privatësi”, Shkolla Verore në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali” dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE në Shqipëri, zhvilluan në datat 30 maj-2 qershor 2017 Shkollën Verore “Informim dhe Privatësi”. Organizimi i këtij aktiviteti kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit të qytetarëve për ushtrimin e të drejtës së privatësisë dhe të qasjes në informacionin zyrtar. Në ceremoninë e mbylljes së Shkollës Verore morën

pjesë z. Bernd Borchardt — Kreu i Prezencës së OSBE në Shqipëri; z. Besnik Dervishi — Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe z. Roland Zisi — Rektor i Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”.

Gjatë ditëve të shkollës verore, studentët u njohën me kuadrin rregullator si dhe me funksionimin dhe kompetencat e Institucionit. Të pranishmit u njohën, nga trajtimi i rasteve konkrete, me procedurat e kërkesës për informim, shqyrtimin e ankesave, rolin e koordinatorit, programin e transparencës së Autoriteteve Publike, si dhe me portalin pyetshtetin.al.

Të pranishmit u informuan veçanërisht, për të drejtat e individit si “subjekt i të dhënave personale” dhe detyrimet e “kontrolluesve”, ndërsa u njohën edhe me funksionet e aplikacionit “IDP Ankesa”. U prezantuan risitë e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE, që hyn në fuqi në maj 2018; siguria në përdorimin e të dhënave në rrjetet sociale, për Internetin e Gjërave (IoT) apo Cloud Computing; ç’janë Big Data, etj. Po ashtu, studentët u njohën edhe me parimin e balancës mes mbrojtjes së privatësisë dhe interesit publik në legjislacionin evropian.





Gjatë 4 ditëve të zhvillimit të Shkollës Verore u trajnuan mbi 100 studentë dhe staf akademik e administrativ të Universitetit të Vlorës. Në aktivitetet u trajtuan tema dhe raste konkrete nga praktika shqiptare dhe ajo evropiane në fushat e mbrojtjes së të dhënave personale dhe në atë të të drejtës për informim.



## Trajnimi “Videosurvejimi dhe mbrojtja e të dhënave personale”



“Videosurvejimi dhe mbrojtja e të dhënave personale” ishte tema e trajnimit të organizuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri.

Aktiviteti kishte për qëllim prezantimin e rregullave dhe parimeve të mbrojtjes së privatësisë në raport me procesin e videosurvejimit. Pjesëmarrës në trajnim ishin përfaqësues të institucioneve qendrore, gjykatave, prokurorisë, policisë, organeve të vetëqeverisjes vendore, sistemit të arsimit dhe shëndetësisë, agjencive të ndryshme të shërbimeve publike, sistemit bankar, kompanive të telekomunikacionit, sigurimeve apo call center, shoqërive të ruajtjes dhe sigurisë fizike, të shoqatave të ndryshme të biznesit, medias, etj.

Z. Besnik Dervishi në përshëndetjen e tij theksoi se “të drejtat themelore të njeriut janë shtyllat e një shoqërie të zhvilluar dhe demokratike. Mbrojtja e të dhënave personale të shtetasve garantohet nga neni 35 i Kushtetutës, ligji 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe aktet nënligjore të Komisionerit të dala në zbatim të tij. Çdo kontrollues – publik apo privat, duhet të përmbushë detyrimet e përcaktuara ndaj qytetarit”. Aktivitetin e përshëndetën edhe përfaqësuesit e Prezencës së OSBE, znj. Sarah McGuckin dhe Policisë së Shtetit, z. Albert Dervishaj.

Zyra e Komisionerit mbajti për pjesëmarrësit prezantime për legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji nr. 9887/2008) dhe përpunimin e tyre nga sistemet e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera (Udhëzimi nr. 3 i Komisionerit). Këto dokumenta normojnë këtë proces në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të kontrolluesve. Mbikëqyrja e vazhdueshme dhe vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit në këtë drejtim ka rritur ndërgjegjësimin e të gjithëve për respektimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve.

Ndërsa, një vëmendje e posaçme në trajnim iu kushtua zbatimit të ligjit të ri 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, si dhe Udhëzimin nr. 46 i Komisionerit “Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”. Në këto akte përcaktohen parimet specifike në përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale të qytetarëve dhe mbrojtja e privatësisë së tyre.



## Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave, ndikimi në vendet candidate për anëtarësim në BE



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Instrumentin e Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX), në datat 14-15 nëntor 2017, organizuan trajnimin me temë “Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ndikimi në vendet candidate për anëtarësim në BE”.

Në këtë aktivitet i ftuar si lektor ishte z. Tino Naumann, përfaqësues i Autoritetit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Landit të Saksonisë në Gjermani.

Në trajnim morën pjesë stafi i Zyrës së Komisionerit, si edhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike; Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Trajnimi u fokusua në risitë që sjell Rregullorja në raport me legjislacionin e BE në fuqi dhe në marrëdhëniet me palë të treta. Ndër temat kryesore që u trajtuan, ishin ato të zgjerimit të kompetencave të Autoritetit të Mbrojtjes së të Dhënave dhe rolit të tij në procesin e certifikimit të kontrolluesve; procedurat e realizimit të hetimeve të përbashkëta; forcimi i rolit të “oficerit të mbrojtjes së të dhënave”, apo “e drejta për t’u harruar”. Aspekte të rëndësishme të trajnimit ishin “transferimi ndërkombëtar i të dhënave”, rritja e kontrollit dhe marrëdhëniet që krijohen me vendet në proces anëtarësimi në BE; si edhe forcimi i sanksioneve si një masë parandaluese për të minimizuar shkeljen e ligjit. Së bashku me Rregulloren, është miratuar edhe Direktiva e re për transferimin e të dhënave për qëllime të hetimit policor apo gjyqësor, e cila, gjithashtu, ishte pjesë e këtij trajnimi.

Prej 25 majit 2018, Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në të gjitha vendet anëtare të BE do të jetë akti kryesor rregullator. Legjislacioni i ri standardizon dhe unifikon praktikën në trajtimin e problematikave në këtë fushë, duke u garantuar kontroll më të madh qytetarëve mbi të dhënat e tyre personale.



## “Mbrojtja e privatësisë në media”



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, bashkëorganizuan workshop-in me temë “Mbrojtja e privatësisë në media”.

Në përshëndetjen e tij, z. Besnik Dervishi vlerësoi se “në një shoqëri demokratike, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dhe në rastin tonë ndërthurja e lirisë së shprehjes me të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, janë garanci të patjetërsueshme për qytetarët e vendit. Legjislacioni që rregullon të drejtën për informim përbën një instrument të domosdoshëm në procesin e llogaridhënies dhe forcimin e kulturës së transparencës, ku media ka rolin e vet në informimin e publikut në funksion të interesit publik”.



Aktivitetin e përshëndeti dhe z. Claus Neukirch, kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri, i cili theksoi se e drejta për lirinë e shprehjes dhe e drejta për jetë private duhet të balancohen në mënyrën e duhur nëpërmjet legjislacionit dhe në praktikën gazetareske e gjyqësore. “Balancimi i këtyre dy të drejtave themelore kërkon ruajtjen e parimeve kryesore që ato mbartin” – tha ai. Ndërsa, z. Musa Ulqini, anëtar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit tha se “Zyra e Komisionerit është një institucion i pavarur dhe i konsoliduar, pavarësisht se në Shqipëri është e vështirë të jesh i pavarur, por ka krijuar kredibilitet në këto 10 vite të funksionimit të saj”.



Në workshop morën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore, nga sistemi i drejtësisë, autoriteteve të pavarura, shoqërisë civile, medias etj. Ekspertë vendas dhe të huaj mbajtën prezantime për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e privatësisë në raport me punën e medias dhe Reformën legislative evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, në trajnim u diskutua për risitë që do të sjellë Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian, me hyrjen e saj në fuqi në maj të 2018-s; si dhe propozimet për modernizimin e Konventës 108-të të Këshillit të Evropës.



Të dy këto dokumenta përbëjnë bazën kryesore rregullatore në kontinentin evropian për trajtimin e standardizuar të problematikave që lindin gjatë përpunimit të të dhënave personale, duke garantuar privatësinë e individit.

Në këtë trajnim u prezantua edhe përkthimi në gjuhën shqipe (realizuar nga Zyra e Komisionerit) i “Manualit të së Drejtës Evropiane në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave”. Ky botim i përgatitur bashkërisht nga Agjencia e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (ADTH), Këshilli i Evropës dhe Zyra e Kancelarit të Gjykatës Evropiane të së Drejtave të Njeriut, është deri më tani përmbledhja më e plotë e jurisprudencës së Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, i hartuar në anglisht dhe frëngjisht dhe përkthyer në 23 gjuhë të ndryshme.

Ky Manual është një udhërrëfyes gjithëpërfshirës i legjislacionit evropian të mbrojtjes së të dhënave, i cili përfshin një panoramë të përgjithshme të kuadrit ligjor në fuqi të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian dhe shtjellon jurisprudencën kryesore të Gjykatës Evropiane të së Drejtave të Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

jtësisë së Bashkimit Evropian.

Në të paraqiten shembuj konkretë dhe skenarë hipotetikë, të cilat kanë për qëllim të ilustrojnë zbatimin në praktikë të rregullave evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave, veçanërisht, kur nuk ekziston jurisprudencë specifike të GjEDNj apo të GjDBE.



## 28 Shtatori, Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim

28 shtatori është Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim. Kjo ditë përkoi me 3-vjetorin e miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim u vendos si e tillë në përfundim të Konferencës “Për lirinë e informimit”, e zhvilluar në Sofje të Bullgarisë, në 26-28 shtator 2002. Vende të ndryshme të botës, Autoritete homologe dhe Organizata jo Fitimprurëse e kremtojnë atë duke organizuar aktivitete dhe nisma që promovojnë këtë të drejtë, si dhe nxisin përmirësimin e kuadrit rregullator për zbatimin e saj.

Me këtë rast, Zyra e Komisionerit krijoi një poster ndërgjegjësues, i cili përkthen në mënyrë vizuale qëllimin kryesor të ligjit për të Drejtën e Informimit, që është ai i mirëqeverisjes në mënyrë transparente, informuese dhe me akses të plotë të qytetarëve në atë çka është zyrtares dhe për këtë arsye publike.

Posteri u vendos në faqet zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale të shumë Autoriteteve Publike, si një nismë për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me ushtrimin e të drejtës për informim.



Në këtë ditë, Zyra e Komisionerit ishte e ftuar për të prezantuar eksperiencën shqiptare në Konferencën ndërkombëtare “Mbrotjtja e të dhënave dhe e drejta e informimit – në kontraditë apo në mbështetje të njëra-tjetrës?”, organizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale të Shtetit të Brandenburgut në Gjermani.

Znj. Ardita Shehaj, Drejtor i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit, mbajti prezantimin me temë “Publikimi proaktiv në internet i informacionit të Autoriteteve Publike, shembulli i një platforme shqiptare”. Gjatë fjalës së saj, znj. Shehaj, i njohu të pranishmit me eksperiencën e Zyrës së Komisionerit në këtë fushë dhe posaçërisht, me funksionimin e portalit “Pyetshtetin.al”. Kjo platformë online e integruar është ngritur për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit për të patur akses më të madh në informacionin me karakter publik.

Konferenca mbledhi përfaqësues nga Autoritete, të organizatave jo fitimprurëse dhe bota akademike nga vende të ndryshme të Evropës. Ata shkëmbyen ide dhe ndanë eksperiencë konkrete, të cilat shërbejnë për më shumë transparencë në funksionimin e shtetit të së drejtës.

Posteri u vendos në faqet zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale të shumë Autoriteve Publike, si një nismë për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me ushtrimin e të drejtës për informim.

## Forcimi i rolit të koordinatorit të të drejtës për informim, takimet e “Grupit të Fokusuar”



“Grupi i Fokusuar në lidhje me kapacitetet e koordinatorit të të drejtës për informim”, iniciativë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (Soros), zhvilloi tryeza të rrumbullakta me përfaqësues të Drejtorive Juridike apo koordinatorë të autoriteteve të pavarura; ministrive dhe institucioneve të varësisë; si dhe organeve të vetëqeverisjes vendore. Në fokus të këtyre takimeve ishte

përmbushja e detyrimeve që parashikohen në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Një nga aspektet kryesore të zbatimit të ligjit është standardizimi i procedurave të brendshme në procesin e kthimit të përgjigjeve. U trajtua gjerësisht çështja e përditësimit sipas specifikave të Programit të Transparencës së këtyre institucioneve. Ndërsa, u diskutua edhe për aspekte të zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duke qënë se është një nga instrumentat e rëndësishëm të informimit të publikut, për rritjen e transparencës e llogaridhënies së Autoriteteve Publike. Fondacioni Soros dhe Zyra e Komisionerit po zbatojnë projektin “Matja e kapaciteteve të koordinatorëve të të drejtës për informim dhe koordinatorëve të njoftimit dhe konsultimit publik”. Nëpërmjet vlerësimit të aspekteve rregullatore dhe profesionale, nisma synon forcimin e rolit të koordinatorëve dhe me përfundimin e projektit, do të hartohet raporti me propozimet përkatëse.



\*\*\*

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri dhe Fondacionin Soros zhvilluan edhe një takim për vlerësimin e ecurisë së zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë të njohur të fushës. Në këtë forum u diskutua edhe për propozime të ndryshme për përmirësimin e këtij ligji.

Zyra e Komisionerit ka nisur një proces konsultimi të gjerë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, standardet e të cilit jo gjithnjë janë zbatuar në mënyrë të uni-fikuar nga Autoritetet Publike. Disa prej çështjeve më të diskutuara në takim ishin ato të konsolidimit të aspektit procedural të Zyrës së Komisionerit në raport me përmbajtjen e informacionit zyrtar; forcimin e rolit të koordinatorit të të drejtës për informim; trajtimin e çështjeve që administrohen në përputhje me legjislacionin “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” në balancë me interesin publik; etj. Pjesëmarrësit në takim ishin të një mendimi përse i përket forcimit të statusit të Komisionerit dhe pavarësisë së tij institucionale. Përmirësimi i këtij ligji në të gjitha aspektet synon që të nxisë akoma edhe më tej ndryshimin e mentalitetit të administratës publike për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.



## Komisioneri anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë

Në Konferencën e 39-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) u zhvilluan zgjedhjet për kreun dhe anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv. Z. Besnik Dervishi, u zgjodh anëtar-vëzhgues në këtë forum. Prej tetorit 2018, ai do të jetë anëtar me të drejta të plota në organin më të lartë drejtues të organizatës. Roli i Komitetit Ekzekutiv është hartimi i politikave dhe dokumenteve të Konferencës Ndërkombëtare, si dhe koordinimi i punës me Autoritetet anëtare në unifikimin e standardeve e praktikave të trajtimit të çështjeve të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.



Me moton “Lidhim Perëndimin me Lindjen për Mbrojtjen dhe Respektimin e Privatësisë” u zhvilluan punimet e Konferencës së 39-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC).

Në këtë aktivitet u miratuan 3 dokumenta të rëndësishme. Ato janë: “Rezoluta për mjetet e automatizuara dhe të ndërlidhura”; “Rezoluta për bashkëpunimin ndërkombëtar të agjencive ligjzbatuese” dhe “Rezoluta për bashkëpunimin në mbrojtje të konsumatorëve”, akte të cilat unifikojnë standardet mbikëqyrëse në 114 Autoritetet e Konferencës. Autoritetet mbikëqyrëse votuan unanimitisht për pranimin e 5 Agjencive të reja, për disa ndryshime të Rregullores së funksionimit të këtij forumi si dhe zgjedhën anëtarët dhe kreun e ri të Komitetit Ekzekutiv. Po ashtu u miratuan raportet e punës 1-vjeçare të Grupeve të Punës në “Edukimin Digjital” – ku Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj, “Indikatorët e Mbrojtjes së të Dhënave”, “Privatësia dhe Aksionet Humanitare”, “Bashkëpunimi Ndërkombëtar mes Agjencive Ligjzbatuese” dhe “E Ardhmja e Konferencës”. U miratua unanimitisht politika e re e Komitetit Ekzekutiv, në caktimin njëkohësisht të organizatorëve të 2 Konferencave të rradhës. Respektivisht, edicioni i 40-të do të bashkëorganizohet nga Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPS) dhe Komisioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Bullgarisë, në tetor të vitit 2018. Ndërsa, edicioni i 41-të i është besuar për t’u organizuar Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale në Tiranë, në vjeshtën e vitit 2019.

## Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve për të Drejtën e Informimit

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në Konferencën e 10-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të të Drejtës për Informim. Gjatë punimeve të saj u trajtuan çështje që kanë lidhje me transparencën e autoriteteve publike dhe zbatimin në praktikë të të drejtës për informim.



Konferenca e këtij viti u organizua bashkërisht nga Komisioneri i Informimit të Mbretërisë së Bashkuar dhe Komisioneri i Informimit të Skocisë. Në këtë aktivitet, Zyra e Komisionerit dha një kontribut të veçantë në seksionin e mbyllur, i titulluar “Sfidat e Autoriteteve të reja të të Drejtës për Informim”.

Në fjalën e mbajtur, znj. Ardita Shehaj, Drejtor i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit, i njohu pjesëmarrësit e Konferencës me funksionimin e Zyrës së Komisionerit, si dhe diskutoi për parësorinë institucionale dhe mbështetjen buxhetore, ndërsa informoi edhe me nismat për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për ushtrimin e të drejtës për informim.

## Konferenca e 10-të dhe Asambleja e 11-të e Përgjithshme e Shoqatës Frankofone të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale

**Au centre :**  
**BESNIK DERVISHI**  
Commissaire du Droit à l'information et à la Protection des Données Personnelles (ALBANIE)



Focus sur l'éducation des enfants et des adolescents à la Protection des Données Personnelles en Albanie.

Suite à la Résolution pour l'adoption d'un référentiel international d'éducation à la protection des données personnelles à l'occasion de la 30ème conférence internationale des commissaires à la protection des données personnelles et de la vie privée, ainsi qu'en qualité de membre du Groupe de travail international sur l'éducation au numérique, le Bureau du Commissaire après la traduction et la publication du Référentiel en albanais, a entamé une campagne de sensibilisation intitulée « Vie privée et sécurité », pour présenter justement le référentiel et la résolution.

En même temps, les experts de communication et des relations publiques de l'IDP ont élaboré une étude sur l'utilisation des réseaux sociaux par les adolescents (15-18 ans), qui doit soutenir, bien évidemment, les efforts du Bureau de Commissaire pendant le processus d'introduction du référentiel, en tant qu'outil de sensibilisation. Les étapes de cette campagne ont compris des rencontres avec des représentants des Directions régionales et des Bureaux de l'éducation du pays entier, puis à des des consultations concernant le Référentiel et plus généralement de l'éducation à la protection de la vie privée et des données personnelles, dans le programme scolaire de l'enseignement obligatoire et secondaire en Albanie.

**Commissariat du Droit à l'information et à la Protection des Données Personnelles (IDP)**

Créé en 2008

Cadre juridique national : Loi n°9887 en date du 10.03.2008, modifiée par la loi n°48/2012 relative à la protection de données à caractère personnel


Effectifs : 35

Réalisation récente :  
Élargissement des compétences de l'Autorité à travers l'attribution du pouvoir de supervision de l'application de la Loi sur le Droit à l'information en 2014  
Premiers contrôles administratifs communs avec les homologues italiens dans la juridiction albanaise en 2017  
Le Commissaire albanais hôte de la Conférence européenne en 2018 et de la Conférence internationale en 2019

Zyra e Komisionerit mori pjesë në Konferencën e 10-të dhe punimet e Asamblesë së 11-të të Përgjithshme të Shoqatës Frankofone të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (AFAPDP). Me rastin e 10-vjetorit të shoqatës, u publikua përmbledhësja 2007 –2017 - 10 vjet AFAPDP” edhe me kontributin e Zyrës së Komisionerit.

Gjatë Asamblesë së 11-të të Përgjithshme të AFAPDP u miratuan disa dokumente, ndër të cilat Rezoluta për Monitorimin e Zhvillimit të Inteligjencës Artificiale, ku theksohet domosdoshmëria e një qasjeje proaktive nga ana e Autoriteteve mbikëqyrëse në raport me zhvillimin e teknologjive në këtë drejtim. Po ashtu, Asambleja miratoi një Marrëveshje Kuadër Bashkëpunimi midis Shoqatës Frankofone të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave (AFAPDP) dhe Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (APF), me të cilën zyrtarizohet një bashkëpunim i hershëm midis këtyre organizmave dhe rregullon shkëmbimin e ekspertizës teknike e zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta.

## Fushata “Privatësi dhe Siguri”, konsultimi i “Kuadrit të aftësimit të mësuesve për mbrojtjen e të dhënave personale”



Krijimi i mjedisit të sigurt digjital është ndër sfidat kryesore të viteve të fundit, ku kontribuojnë edhe Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale për edukimin e të brezit të ri. Miratimi i “Kuadrit të aftësimit të mësuesve të shkollave 9-vjeçare për mbrojtjen e të dhënave personale” në Konferencën e 38-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC), i hartuar nga Grupi i Punës për Edukimin Digjital (DEWG), ka hedhur bazat për një aksion gjithëpërfshirës në shkallë botërore.

Raporti i Grupit të Punës për periudhën 2016-2017 ka theksuar angazhimin e shumë Autoriteteve, mes të cilave edhe të Zyrës së Komisionerit, të cilat janë duke punuar në këtë drejtim. Është konsideruar si sukses përkthimi i “Kuadrit të aftësimit” në 6 gjuhë të tjera të ndryshme, mes tyre edhe në shqip (dokumenti original: në anglisht dhe në frëngjisht).

Zyra e Komisionerit është duke zhvilluar fushatën “Privatësi dhe Siguri” për të konsultuar “Kuadrin e aftësimit” me mësues e psikologë të arsimit të detyrueshëm nëpër qytete të ndryshme të vendit.

Grupi i Punës për Edukimin Digjital i krijuar në vitin 2013, ku dhe Zyra e Komisionerit është anëtare, bashkëdrejtohet nga Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Francës dhe Kanadasë. Ky forum i Konferencës Ndërkombëtare ka për qëllim diskutimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira që promovojnë edukimi digjital në grupmoshat parauniversitare.



Takimi në Gjirokastrë

Pjesë e takimeve të zhvilluara deri tani në qarqet e Dibrës, Kukësit, Shkodrës, Lezhës, Gjirokastrës, Elbasanit dhe Korçës kanë qënë mësues të lëndëve të edukatës shoqërore, TIK, psikologë dhe punonjës social.

“Kuari i aftësisë” është një dokument me 9 parime kryesore për edukim të përgjegjshëm dhe për të rritur sigurinë në mjedisin digjital. Mësuesit marrin njohuritë bazë për mbrojtjen e privatësisë: legjislacionin e fushës; për qëllimin, mënyrat dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale; të drejtat në rastet e keqpërdorimit të tyre; çështjet që kanë të bëjnë me aspekte teknike të sigurisë së të dhënave, etj. Ai është hartuar nga Grupi i Punës për Edukimin Digjital (DEWG), pjesë e të cilit është edhe Zyra e Komisionerit. Ky dokument synohet që të përfshihet në të ardhmen në kurrikulën e arsimit 9-vjeçar.



Takimi në Shkodër



Takimi në Lezhë

## “Informim dhe Privatësi” Trajnim në Akademinë e Policisë

Në kuadër të trajnimeve, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, në datat 21-22 nëntor 2017, trajnimin “Informim dhe Privatësi”.



Në këtë trajnim morën pjesë staf akademik dhe administrativ nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit. Në ditën e parë të trajnimit të pranishmit u njohën me parimet kryesore të përpunimit të të dhënave, që parashikohen në ligjin 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Gjithashtu, u trajtua edhe ligji 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe Udhëzimet nr. 3 (përpunimi i të dhënave me sisteme videosurvejimi) dhe nr. 46 (niveli i sigurisë së përpunimit të të dhënave nga masat shtesë të sigurisë) të Komisionerit, në raport me respektimin e të drejtës së qytetarëve për privatësi. Këto akte normojnë detyrimet e “kontrolluesve” dhe të drejtat e individit në rastet e keqpërdorimit të të dhënave personale.

Në ditën e dytë u trajtuan çështje që preken nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, zbatimi i unifikuar i të cilit është instrument për rritjen e llogaridhënies së Autoriteteve Publike. Nëpërmjet rasteve praktike, të pranishmit u njohën me vendimmarrjen e Zyrës së Komisionerit

në të dy këto fusha. Mbikëqyrja e vazhdueshme e akteve rregullatore rrit ndërgjegjësimin e të gjithëve për respektimin e privatësisë së qytetarëve dhe garantimin e të drejtës së tyre për informim.





## Konferenca rajonale “Për të Drejtën e Informimit” Sarandë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi në qytetin e Sarandës konferencën rajonale “E drejta për informim, autoritetet publike, koordinatori dhe programet e tran-sparencës”. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të bashkive të Sarandës, Delvinës, Finiqit dhe Konispolit; të organeve të drejtësisë; institucioneve qendore në nivel vendor; nga shoqëria civile; media, etj.

Z. Besnik Dervishi, në fjalën e tij tha se “konferenca të kësaj natyre janë zhvilluar në të gjithë territorin e vendit dhe theksoi se ligji “Për të drejtën e informimit” përbën një revolucion në ndryshimin e mentalitetit dhe kulturës së administratës publike”. Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e institucioneve shtetërore dhe bashkëpunon me to për adresimin e problematikave që ndeshen gjatë zbatimit të ligjit. Njëkohësisht, duhet forcuar roli i koordinatorit për të drejtën e informimit, si dhe të përmirësohen programet e transparencës për të reflektuar specifikat e Autoriteteve Publike.

Zyra e Komisionerit mbajti një prezantim për të pranishmit duke i njohur ata në mënyrë të detajuar me komponentët e këtij ligji, me funksionimin e Autoritetit tonë dhe me raste praktike. Prezantimi shërben si një udhërrëfyes në procesin e trajtimit të kërkesave të qytetarëve. U vlerësua me rëndësi hartimi, plotësimi me sa më shumë informacion dhe përditësimi i programit të transparencës nga Autoritetet Publike. Zyra e Komisionerit prezantoi edhe funksionet e portalit pyetshtetin.al si një platformë e integruar informative për qytetarët.

Me konferencën e Sarandës u shënua përmbyllja e Programit të Konferencave Rajonale të zhvilluara nga Zyra e Komisionerit në periudhën nëntor 2015 – korrik 2017 në të gjithë vendin. Në këtë takim të fundit u analizuan ecuria e zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe problematikat e konstatuara, me synimin që trajtimi i kërkesave të qytetarëve të bëhet në mënyrë të standardizuar.



## Zyra e Komisionerit në forume kombëtare



Qendra për Çështje të Informimit Publik – INFOÇIP, prezantoi gjetjet e “Monitorimit Kombëtar për ligjin e të drejtës për informim nga bashkitë e Shqipërisë”.

Në këtë aktivitet ishte i ftuar për të mbajtur një prezantim dhe z. Besnik Dervishi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në fjalën e tij, ai theksoi se ligji përbën një revolucion në ndryshimin e mentalitetit dhe kulturës së administratës publike, ndërkohë që Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar

me organet e pushtetit vendor për adresimin e problematikave që ndeshen gjatë zbatimit të tij. Zyra e Komisionerit përshëndet rezultatet e arritura nga bashkitë e Tiranës, Korçës dhe Shkodrës në këtë monitorim, ndërsa, konstatojmë se jo pak herë ka mosnjohje të detyrimeve ligjore nga njësitë e pushtetit vendor, neglizhencë në përmbushjen e tyre, apo dhe raste të mungesës së vullnetit për transparencë.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte i ftuar në takimin “Mbi forcimin dhe ngritjen e kapacitetit të rrjetit të avokatëve të rinj” të organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.



Z. Besnik Dervishi informoi të pranishmit me kuadrin rregullator, duke u fokusuar tek praktikat që zbaton Zyra e Komisionerit mbi kërkesat në lidhje me informacionin e klasifikuar dhe çështjet e korrupsionit dhe tenderat/prokurimet publike. “Efikasiteti në luftën kundër korrupsionit duke përmbushur detyrimet e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” garanton transparencën e Autoriteteve Publike dhe rrit besimin e qytetarëve tek institucionet. Ndryshimi i mentalitetit të administratës publike shqiptare është një reformë po aq e rëndësishme sa edhe ajo në sistemin e drejtësisë. Ligji 146/2014 “Për njoftim dhe konsultimin publik” është një tjetër instrument i rëndësishëm në procesin e llogaridhënies së institucioneve në funksion të interesit publik” – tha z. Dervishi.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte i ftuar në “Forumit e 3-të për Zhvillimin e Medias” të organizuar nga Prezenca e OSBE (Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë) në Shqipëri.



Z. Besnik Dervishi në fjalën e tij, trajtoi detyrimet e Zyrës së Komisionerit për bërjen e balancës mes dy të drejtave, asaj për një jetë private dhe të drejtës për informim. “Vendimmarrja e Komisionerit është udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit në rastet e ndërthurjes së dy të drejtave. Nga ana tjetër, duhet të nxisim dhe forcojmë kulturën e transparencës, ku media ka rolin e saj. Në këtë këndvështrim, rëndësi të veçantë ka dallimi midis saj që paraqet interesi publik, nga ajo që është thjesht interesi për publikun” – tha z. Dervishi.



# Informim Dhe Privatësi

**Revista nr.4**



Adresa:  
Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5,  
Kodi postar 1001, Tiranë  
E-mail: [info@idp.al](mailto:info@idp.al)  
TEL: +35542237200  
FAX: +35542233977  
Nr. i Gjelbër: 08002050

**[www.idp.al](http://www.idp.al)**